



**Komisioni i
Pavarur i
Kualifikimit**

NJOFTIM MBI SEANCËN E SHPALLJES SË VENDIMIT PËR

SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT ZNJ OLTIANA GJONI (ÇIFLIKU)



04/09/2024

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 3.9.2024, për subjektin e rivlerësimit, znj. Oltiana Gjoni (Çifliku), bazuar në ligjin nr. 84/2016, vendosi:

Konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Oltiana Gjoni (Çifliku), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, nga trupi gjykues i kryesuar nga z. Roland Ilia, znj. Genta Tafa Bungo relatore, znj. Suela Zhegu anëtare do t'i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall sot, në datën 4.9.2024.

*Informacioni është aksesuar në faqen e KPK më datë 04.09.2024 në linkun: <https://kpk.al/njoftim-mbi-seancen-e-shpalljes-se-vendimit-per-subjektin-e-rivleresimit-znj-oltiana-gjoni-cifliku/52/>